



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

Çfarë synon Strategjia për Punësim dhe Aftësim?

2014-06-10 15:42:00

Në themel të vizionit të SPZhA është kualifikimi cilësor profesional i forcës punëtore për t'iu përgjigjur si duhet tregut si dhe nxitja e hapjes së vendeve të reja cilësore të punës. Fokusi i saj është integrimi i sistemit të AFP me politikat aktive të punësimit dhe kohezionit social. Strategjia është hartuar me ndihmën e një grupi ekspertësh vendas dhe të huaj, në përputhje me strategjinë Europiane të punësimit dhe vizionin e prioritetet e qeverisë shqiptare.

Në themel të vizionit të SPZhA është kualifikimi cilësor profesional i forcës punëtore për t'iu përgjigjur si duhet tregut si dhe nxitja e hapjes së vendeve të reja cilësore të punës. Fokusi i saj është integrimi i sistemit të AFP me politikat aktive të punësimit dhe kohezionit social. Strategjia është hartuar me ndihmën e një grupi ekspertësh vendas dhe të huaj, në përputhje me strategjinë Europiane të punësimit dhe vizionin e prioritetet e qeverisë shqiptare.

Mbështetur në vizionin dhe qëllimet, SPZhA parashikon ndërhyrjen mbështetur në katër shtylla kryesore. Këto shtylla prekin të gjithë arsenalin e politikave dhe mjeteve për zbatimin e tyre të cilat ka në dispozicion Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ato janë:

Prioritetet strategjike

Transformim të shërbimeve të programeve të punësimit

Rritje të cilësisë së arsimit dhe formimit profesional

Arritja e grupeve më në nevojë në mbarë vendin

Ngritja e një tregu pune dhe sistemi kualifikimesh funksional

Kjo strategji, nuk përfshin çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë apo sipërmarrjeve, përmirësimin e klimës së biznesit në vend, rritjen e eksporteve apo nxitjen e investimeve të huaja. Por, kjo strategji synon sistemin tone të aftësimin profesional, rritjes së kualifikimet të forcës sonë të punës me qëllim rritjen e produktivitetit të saj.

Vizioni ynë i synuar është që në 2020 Shqipëria të ketë një sistem cilësor Arsimit dhe Formimit Profesional si dhe programe punësimi efektive dhe funksionale. Objektivat kryesore për këto sektorë deri në 2020 janë:

